



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 19 regjistër (JR)  
Datë 09.06.2020

Nr. 41 i vendimit  
Datë 23.12.2020

**VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

|                        |                  |
|------------------------|------------------|
| <b>Albana Shtylla</b>  | <b>Kryesuese</b> |
| <b>Sokol Çomo</b>      | <b>Relator</b>   |
| <b>Ardian Hajdari</b>  | <b>Anëtar</b>    |
| <b>Natasha Mulaj</b>   | <b>Anëtare</b>   |
| <b>Rezarta Schuetz</b> | <b>Anëtare</b>   |

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 23.12.2020, ora 13:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Steven Kessler, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 19/2020 (JR), datë 09.06.2020, që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit, znj. Eneida Civici, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 251, datë 09.03.2020, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Eneida Civici.

**BAZA LIGJORE:** Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut; Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998; ligji ndryshues nr. 76/2016, datë 22.07.2016; neni 63 i ligjit nr. 84/2016; neni 46 i ligjit nr. 49/2012.

**Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në prani të ankueses (përveç seancës për shpalljen e vendimit në të cilën ajo nuk u paraqiti), në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

## VËREN:

### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Eneida Civici, në momentin e fillimit të procesit të rivlerësimit kalimtar nga Komisioni, ushtronte detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Për shkak të parashikimeve të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe dispozitave të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Eneida Civici i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.
2. Në datën 23.10.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”) i ka përcjellë Komisionit vendimin e tij nr. 226, datë 22.10.2019, “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Eneida Civici”, me anë të të cilit ka vendosur deklarinimin e mbarimit të statusit të magjistratit për znj. Eneida Civici, për shkak të dorëheqjes së saj me motivin “e angazhimit në një pozicion pune jashtë sistemit gjyqësor”, me efekt nga data 31.10.2019.
3. Komisioni, në kuadër të procesit të rivlerësimit për subjektin, znj. Eneida Civici, ka administruar nëpërmjet KLGj-së konfirmimin e Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë se ndaj vendimit të KLGj-së nr. 226, datë 22.10.2019, “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, znj. Eneida Civici”, deri në datën 27.12.2019, nuk është paraqitur ankim.
4. Në rrethanat e mësipërme, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) ndërpreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Eneida Civici, me vendimin nr. 251, datë 09.03.2020.

### II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

5. Komisioni, me vendimin nr. 251, datë 09.03.2020, bazuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 64 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vendosi:
  1. Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Eneida Civici.
  2. Të deklarojë humbjen e së drejtës për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.[...]

### III. Shkaqet e ankimit

6. Subjekti i rivlerësimit, znj. Eneida Civici, më datë 16.04.2020, ushtroi ankim ndaj vendimit të Komisionit nr. 251, datë 09.03.2020, vetëm sa i takon pikës 2 të tij me përmbajtje: *Të deklarojë humbjen e së drejtës për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15 vjeçare.*

7. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se kjo pjesë e dispozitivit të vendimit konsiston në një parashikim joproporcional dhe në kundërshtim me parimet bazë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe se ky vendim është marrë në shkelje të rënda të ligjit procedural të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në vlefshmërinë e tij dhe e bëjnë atë të cenueshëm nga organet më të larta të kontrollit siç është Kolegji.
8. Subjekti i rivlerësimit, znj. Eneida Civici, kërkoi nga Kolegji që, pas shqyrtimit të shkaqeve të ngritura në ankimin e saj, të vendosë:
  - ° *Shfuqizimin e pikës 2 të vendimit nr. 251, datë 09.03.2020, të Komisionit.*
9. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

**9.1 Lidhur me procesin e zhvilluar në Komision,** subjekti pretendoi se janë kryer shkelje të rënda procedurale nga ana e trupit gjykues të çështjes në drejtim (i) të mosnjoftimit të rregullt të përbërjes së trupit gjykues; (ii) të mosbashkimit të çështjes së rivlerësimit për subjektin, znj. Eneida Civici, me çështjen tjetër të rivlerësimit të subjektit A. C. (bashkëshort i subjektit të rivlerësimit) dhe mosnjoftimin e këtij vendimi; (iii) të mungesës së pavarësisë së trupit gjykues në kryerjen e procedurave të rivlerësimit; dhe (iv) të cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor të subjektit të rivlerësimit në caktimin e sanksionit sipas pikës 2 të vendimit të Komisionit.

**9.2 Lidhur me pikën 2 të vendimit objekt ankimi,** subjekti i rivlerësimit, znj. Eneida Civici, pretendoi se “sanksioni” i vendosur nga Komisioni në këtë pikë të vendimit është joproporcional, për sa kohë ajo ka paraqitur dorëheqjen nga detyra, e detyruar nga shkeljet e kryera nga Komisioni gjatë procedurës së rivlerësimit të saj. Subjekti pretendoi se, me dorëheqjen e saj nga detyra, nuk ka pasur qëllim t’i shmanget procesit të *vetting*-ut, por në mbrojtje të së drejtës themelore për jetë familjare, ka zgjedhur në përputhje me të drejtat dhe liritë e saj një tjetër punë.

#### **IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit**

##### *A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit*

##### *a) Juridiksioni i Kolegjit*

10. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin, znj. Eneida Civici, dhe për të cilin ajo, nëpërmjet ankimit, kërkon shfuqizimin e pikës 2 të tij, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

*b) Legjitimimi i ankuesit*

11. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh<sup>1</sup>, nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

*c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

12. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues në vijim vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhej me shqyrtimin e ankimit të subjektit të rivlerësimit ndaj vendimit të Komisionit nr. 251, datë 09.03.2020, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi, nga ku u konstatua se gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, është cenuar e drejta e subjektit të rivlerësimit për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore sipas parashikimeve të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, trupi gjykues, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, në nenin 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, si dhe në nenin 51, pika 1, germa "b" e ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, vendosi shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike e cila u zhvillua me praninë e subjektit të rivlerësimit.

*B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit*

13. Në lidhje me shkakun e ankimit për shkelje të rregullave procedurale në drejtim të pretendimit për mosnjoftimin e rregullt të subjektit të rivlerësimit lidhur me përbërjen e trupit gjykues të Komisionit, subjekti i rivlerësimit, znj. Civici, pretendoi se asaj i është komunikuar më datë 08.01.2019, trupi gjykues që do të shqyrtonte çështjen e rivlerësimit të saj me përbërje komisionerët A. F., B. B. dhe Xh. P., ndërkohë që, referuar përmbajtjes së vendimit të Komisionit, subjekti ka konstatuar që fillimisht pjesë e trupit gjykues ka qenë komisioneri O. K., i cili në vijim të kërkesës për dorëheqje nga ky proces i rivlerësimit, është zëvendësuar me komisioneren A. F. Në ndryshim me sa më sipër, sipas subjektit të rivlerësimit, në vendimin nr. 251, datë 09.03.2020, trupi gjykues paraqitet me përbërje të komisionerëve A. F., B. B. dhe L. H.

---

<sup>1</sup> Siç rezultoi nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 251, datë 09.03.2020, për rivlerësimin e subjektit, znj. Eneida Civici, i është njoftuar asaj me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 03.04.2020, konfirmuar marrja dijeni në datën 09.04.2020, sipas lajmërimarrjes përkatëse. Ndërkohë ankimi i subjektit të rivlerësimit është depozituar pranë Komisionit më datë 16.04.2020, protokolluar me nr. {\*\*\*} prot., datë 17.04.2020. Në këto kushte, subjekti rezultoi të ketë ushtruar ankim në ditën e 7-të të afatit ligjor për të ushtruar ankim, në përputhje me nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

14. Referuar sa më sipër, subjekti i rivlerësimit pretendoi se nuk është njohur në mënyrë të rregullt me përbërjen e trupit gjykues dhe ndryshimet e mëvonshme që ka pësuar ai, duke i cenuar asaj këtë të drejtë procedurale të garantuar me ligj dhe eventualisht duke i cenuar të drejtën për të deklaruar konfliktin e mundshëm të interesit mes saj dhe komisionerit L. H. Subjekti ngriti dyshime edhe në lidhje me deklarinimin për mungesë të konfliktit të interesit nga ana e vetë komisionerit L. H. pasi, sipas subjektit të rivlerësimit, referimi në vendimin e Komisionit: *Në mbledhjen e trupit gjykues, më datë 20.11.2018, u deklarua mungesa e konfliktit të interesit nga komisionerët L. H. dhe B. B., ndërkohë që komisioneri O. K. për këtë subjekt deklaroi konfliktin e interesit [...] – është i pavërtetë* pasi, referuar njoftimit të marrë nga Komisioni më datë 08.01.2019, për përbërjen e trupit gjykues, rezultoi se deri në këtë datë komisioneri L. H. nuk ka qenë pjesë e trupit gjykues dhe, për rrjedhojë, ai nuk kishte si të ishte i pranishëm në mbledhjen e trupit gjykues të zhvilluar më datë 20.11.2018.
15. Në shqyrtim të pretendimeve të parashtruara si më sipër nga ana e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të përcjellë në Kolegj nga ana e Komisionit, konstatoi si vijon.
- 15.1. Referuar procesverbalit të Mbledhjes së Komisionit nr. {\*\*\*} prot., datë 15.11.2018, trupi gjykues për rivlerësimin kalimtar të subjektit të rivlerësimit, znj. Eneida Civici, është caktuar sipas procedurës së shortit dhe me përbërje komisionerët O. K., Xh. P. dhe B. B. Anëtar zëvendësues, sipas kësaj procedure shorti, ka rezultuar komisionerja A. F.
- 15.2. Më datë 20.11.2018, komisioneri O. K. ka deklaruar konfliktin e interesit në hetimin e kësaj çështjeje rivlerësimi dhe, me vendimin e datës 23.11.2018, një trup i ndryshëm gjykues, i zgjedhur nëpërmjet procedurës së shortit për shqyrtimin e kërkesës së komisionerit O. K., ka vendosur pranimin e kërkesës së tij dhe, për rrjedhojë, ky i fundit është zëvendësuar nga komisionere A. F., e cila ishte zgjedhur në shortin e datës 15.11.2018 si anëtare zëvendësuese.
- 15.3. Referuar përmbajtjes së “kërkesës për dorëheqje”<sup>2</sup> të komisioneres Xh. P. drejtuar anëtareve të trupit gjykues A. F. dhe B. B., sipas së cilës kërkesa për dorëheqje nga komisionerja Xh. P. është bërë në zbatim të vendimit të Komisionit nr. 6, datë 21.01.2019, për shqyrtimin me trupa të ndryshëm gjykues të subjekteve që janë bashkëshortë<sup>3</sup>, kuptohet që kërkesa e komisioneres Xh. P. daton pas datës 21.01.2019. Shtuar fakti që, me vendimin e Mbledhjes së Komisionit nr. {\*\*\*}, datë 30.01.2019, “Për ngritjen e trupit gjykues që do të marrë në shqyrtim kërkesën për dorëheqje të komisioneres Xh. P. nga rivlerësimi i subjektit, znj. Eneida Civici”, është disponuar mbi kërkesën për dorëheqje të komisioneres Xh. P., arrihet në përfundimin që kjo kërkesë është bërë në intervalin kohor 21.01.2019 -30.01.2019, për rrjedhojë, deri më datë 21.01.2019, trupi gjykues ka pasur në përbërje komisionerët A. F. (anëtar zëvendësues i komisionerit O. K.) që nga data 23.11.2018, B. B. dhe Xh. P.
- 15.4. Me vendimin e datës 04.02.2019 të trupit gjykues të Komisionit, të zgjedhur me short për shqyrtimin e kërkesës për dorëheqje të Komisioneres Xh. P. është vendosur pranimi i kërkesës dhe

<sup>2</sup> Kjo kërkesë nuk mban datë.

<sup>3</sup> Pasi komisionerja Xh. P. rezultonte anëtare e trupit gjykues edhe për rivlerësimin e subjektit A. C., bashkëshorti i znj. Eneida Civici.

në vijim, me vendimin nr. 10, datë 06.02.2019, “Për caktimin me short të anëtarit zëvendësues në çështjen e subjektit të rivlerësimit, znj. Eneida Civici”, është caktuar me short komisioneri L. H. Për pasojë, trupi gjykues për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Eneida Civici, kishte tashmë në përbërje komisionerët A. F., B. B. dhe L. H., të cilët morën dhe vendimin objekt ankimi.

16. Në kuadër të sa më sipër konstatuar, duke pasur parasysh parashikimet ligjore që rregullojnë procesin e rivlerësimit, dispozitat në fuqi të legjislacionit procedural civil dhe atij administrativ, trupi gjykues vlerësoi se përbërja e trupit gjykues ka qenë e rregullt, pasi ajo është caktuar dhe ka ndryshuar në vazhdim, në përputhje me dispozitat e zbatueshme në fuqi, sipas një procedure shorti. Edhe pse njoftimi i subjektit lidhur me ndryshimet e pësuar në trupin gjykues, si pasojë e caktimit të anëtarëve zëvendësues nuk u konstatua nga dokumentacioni i administruar në fashikull dhe, për rrjedhojë, mund të mos ketë ndodhur, trupi gjykues çmoi se kjo parregullsi procedurale në njoftimin e subjektit të rivlerësimit nuk u provua të ketë cenuar thelbin e së drejtës së subjektit të rivlerësimit për proces të rregullt ligjor. Trupi gjykues arriti në këtë konkluzion pasi konstatoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Eneida Civici, edhe pse pretendoi se mosnjoftimi i caktimit në trupin gjykues të komisionerit L. H., i ka cenuar të drejtën për t’u shprehur lidhur me konfliktin e mundshëm të interesit me këtë anëtar të trupit gjykues, pas ardhjes në dijeni të këtij fakti me vendimin nr. 251, datë 09.03.2020, nuk pretendoi në ankimin e saj ekzistencën e konfliktit të interesit me këtë komisioner.
17. Për rrjedhojë, në vlerësimin e trupit gjykues, vendimi i marrë nga trupi gjykues i Komisionit, përbërja e të cilit ka qenë e rregullt dhe në përputhje me ligjin, por që nuk i është bërë e ditur rregullisht dhe në kohë subjektit të rivlerësimit, znj. Eneida Civici, nuk rezultoi të jetë i cenueshëm në drejtim të ekzistencës së shkaqeve, të cilat, në dukje apo në thelb, cenojnë paanësinë e trupit vendimmarrës. Në kuptim të sa më sipër, ky pretendim i subjektit të rivlerësimit, në vlerësimin e trupit gjykues, nuk përbën shkak për cenueshmërinë e vlefshmërisë së vendimit të Komisionit objekt ankimi.
18. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për paraqitje në vendim të fakteve të pavërteta sa i takon prezencës së komisionerit L. H. në mbledhjen e datës 20.11.2018, ky pretendim, në kuadër të konstatimeve të sipërcituara në paragrafin 15, më sipër në vendim, gjendet i drejtë. Megjithatë, duke pasur parasysh që dyshimet e ngritura nga ana e subjektit të rivlerësimit, znj. Eneida Civici, në drejtim të mosdeklarimit të konfliktit të interesit të këtij komisioneri në çështjen e saj, rezultuan të pabaza, pasi deklarata për mungesë konflikti interesi e këtij komisioneri në rivlerësimin e këtij subjekti, është nënshkruar rregullisht dhe është pjesë e fashikullit të çështjes, trupi gjykues e vlerësoi këtë moment të shprehur në vendimin e Komisionit mbi prezencën e komisionerit L. H. në mbledhjen e trupit gjykues ku është deklaruar mungesa e konfliktit të interesit, si një gabim material, i cili nuk përbën shkak për cenimin e vendimit.
19. Në lidhje me pretendimet e subjektit të rivlerësimit në drejtim të vendimmarrjes së Komisionit për mosbashkimin e çështjeve të rivlerësimit të saj dhe subjektit tjetër të rivlerësimit A. C. (bashkëshorti i znj. Eneida Civici), trupi gjykues çmoi se pretendimet lidhur me shkelje procedurale në drejtim të mosbashkimit të proceseve të rivlerësimit për të dyja këto subjekte dhe të mosnjoftimit të këtij vendimi, nuk janë relevante në drejtim të zgjidhjes së çështjes së

rivlerësimi objekt kontrolli nga Kolegji, e cila në thelbin e saj ka një ankim ndaj një vendimi të Komisionit që ka vendosur ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin ankues. Në çdo rast, në vlerësim të karakterit të veçantë të procesit të rivlerësimit, i cili kryhet për çdo subjekt në mënyrë individuale, në drejtim të tri shtyllave kryesore, vlerësimi të pasurisë, pastërtisë së figurës dhe aftësive profesionale, trupi gjykues arriti në përfundimin se bashkimi i dy proceseve të rivlerësimit në një proces të vetëm, nuk parashikohet nga ligji i posaçëm, pasi vendimet e organeve të rivlerësimit janë individuale për çdo subjekt rivlerësimi dhe rrjedhojë e vlerësimit objektiv dhe të pavarur të secilit prej tri kriterëve të vlerësimit për secilin prej tyre. Në përfundim të sa më sipër, pretendimet e subjektit të rivlerësimit për shkelje procedurale në drejtim sa më sipër, përveçse pa efekt në kuadër të ankimit të ngritur për kundërshtimin e një pjese të vendimit të Komisionit, i cili ka ndërprerë procesin e rivlerësimit për subjektin, znj. Eneida Civici, u vlerësuan edhe si të pabazuara në ligj.

20. Subjekti i rivlerësimit, znj. Eneida Civici, pretendoi se në cenim të parimit të pavarësisë, Komisioni, i ndikuar nga thirrja e ministres së Drejtësisë në një konferencë të saj për shtyp të datës 20.10.2019, të dhënë kundër një vendimi të KLD-së në atë kohë, ka përfshirë në listën e radhës të miratuar me vendimin nr. {\*\*\*}, të datës 08.11.2018, të subjekteve që do t'i nënshtroheshin procedurës së *vetting*-ut edhe anëtarët e KLD-së, pavarësisht se, sipas saj, ligji nr. 86/2016<sup>4</sup> nuk i parashikon anëtarët e KLD-së si subjekte të posaçme që duhej t'i nënshtroheshin *vetting*-ut me përparësi. Sipas subjektit të rivlerësimit, miratimi i listës së subjekteve për t'u rivlerësuar erdhi menjëherë pas kërkesës publike dhe politike të ministres së Drejtësisë drejtuar Komisionit, për të shkarkuar të gjithë gjyqtarët që ishin anëtarë të KLD-së dhe që kishin miratuar vendimin me të cilin, sipas subjektit të rivlerësimit, ministria nuk ishte dakord.
21. Lidhur me sa më sipër, trupi gjykues konstatoi se në vendimin nr. 251, datë 09.03.2020, në paraqitjen e rrethanave të çështjes, Komisioni shprehet se subjekti i rivlerësimit, znj. Eneida Civici, gjatë periudhës së fillimit të procesit të hetimit administrativ ka ushtruar detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe, për rrjedhojë, për shkak të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, ky subjekt i është nënshtuar procesit të rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
22. Sipas Komisionit, ndryshe nga sa pretendoi subjekti i rivlerësimit, znj. Eneida Civici, në ankim, kjo e fundit nuk rezultoi t'i jetë nënshtuar procesit të rivlerësimit *ex officio* dhe me përparësi në kohë. Përveç konstatimit të mësipërm, trupi gjykues konstatoi se në fashikullin e përcjellë nga Komisioni në Kolegji, nuk ka asnjë të dhënë, informacion apo dokumentacion, sipas të cilit vendimmarrja e Komisionit e datës 08.11.2018, për miratimin e listës së subjekteve që do t'i nënshtroheshin procesit të rivlerësimit, të jetë diktuar nga ministrja e Drejtësisë apo nga ndonjë autoritet tjetër jashtë strukturave të organeve të rivlerësimit. Gjithashtu, as subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti ndonjë provë në mbështetje të pretendimit të saj, që nisja e procedurave për rivlerësimin e saj të jetë kryer me përparësi në kohë, si pasojë e ndikimit të pushtetit ekzekutiv.

---

<sup>4</sup> Referenca ligjore nga subjekti i rivlerësimit duket të jetë lapsus pasi akti në fjalë i referohet një ligji ratifikues të një marrëveshjeje ndërkombëtare mes Këshillit të Ministrave dhe qeverisë italiane.

23. Trupi gjykues, në drejtim të pretendimit të subjektit të rivlerësimit për cenim të parimit të pavarësisë, si pasojë e sa më sipër, çmoi të mbajë në konsideratë se këto pretendime, në rastin objekt gjykimi i referohen më së shumti Komisionit në drejtim të procedurave për fillimin e procesit të rivlerësimit dhe jo të vendimmarrjes konkrete të trupit gjykues të çështjes, e cila konsiston në ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, si pasojë e dorëheqjes nga detyra të vetë subjektit të rivlerësimit. Në këtë kontekst, pretendimet për ndërhyrje politike dhe cenim të pavarësisë së Komisionit në kuptim të sa më sipër, u vlerësuan nga trupi gjykues se, përveçse mbetën në nivel pretendimi të pabazuar në fakte, në çdo rast nuk mund të përbëjnë shkak për cenimin e vendimmarrjes së Komisionit për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Eneida Civici.
24. *Lidhur me shkakun e ankimit për cenim të procesit të rregullt*, subjekti pretendoi se procesi për dhënien e një mase ndëshkimore sipas pikës 2 të vendimit, është zhvilluar në mënyrë të njëanshme dhe pa respektuar parimet e një procesi të rregullt ligjor, duke shkelur rëndë nenin 6 të KEDNj-së. Sipas subjektit të rivlerësimit, dhënia e një mase të tillë kaq të rëndë sa humbja e së drejtës për të qenë gjyqtar ose prokuror për një periudhë 15-vjecare, kërkonte që procedura e ndjekur nga Komisioni të ishte në respektim të plotë të ligjit procedural dhe material. Sipas subjektit të rivlerësimit, znj. Eneida Civici, Komisioni ka cenuar parimin e barazisë së armëve, pasi nuk i ka garantuar asaj të drejtën për t'u njohur me përgjigjet e kërkesave të saj, me ndryshimet e trupit gjykues, si dhe me çdo dokument tjetër që do të merrte në shqyrtim Komisioni në këtë proces dhe t'i garantonte asaj të drejtën për t'u shprehur lidhur me to. Subjekti i rivlerësimit pretendoi edhe se, referuar jurisprudencës së GJEDNj-së, trupi gjykues në Komision nuk përmbushte kriteret e përfaqësimit nga gjyqësori, për ta vlerësuar atë si një organ disiplinor, në përputhje me kërkesat e pavarësisë dhe paanësisë.
25. Në shqyrtim të pretendimeve të mësipërme të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues fillimisht konstatoi se, nga verifikimi i procedurave të ndjekura në Komision referuar akteve të administruara në fashikullin e çështjes, Komisioni ka vendosur lidhur me ecurinë e procesit të rivlerësimit të znj. Eneida Civici mbi bazë dokumentesh, pa i dhënë të drejtën subjektit të rivlerësimit të njihet lidhur me rezultatin e pritshëm të ndërprerjes së procedurës së rivlerësimit dhe të drejtën për t'u dëgjuar, si dhe për të mbrojtur interesat e saj të ligjshëm lidhur me ecurinë e karrierës së saj. Komisioni në vendimin e tij nuk shprehet lidhur me të drejtën e subjektit për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore, si dhe rrethanat të cilat kanë legjitimuar përjashtimin e saj nga kjo e drejtë, referuar rasteve të përcaktuara shprehimisht në nenin 89 të Kodit të Procedurave Administrative.
26. Referuar jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit, mosmbajtja e seancës dëgjimore nga Komisioni, në kundërshtim me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe në mungesë të rasteve përjashtimore të përcaktuara në mënyrë shteruese në nenin 89 të Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilave procedura administrative mund të mbyllet pa nevojën e njoftimit të subjektit dhe pa i dhënë mundësinë këtij të fundit për t'u dëgjuar lidhur me çështjen e tij, vlerësohet si mosrespektim nga ana e Komisionit i së drejtës së subjektit për t'u dëgjuar në shqyrtimin e çdo çështjeje që sjell pasoja të drejtpërdrejta mbi statusin e tij ligjor. Ndërsa sjellja procedurale e



Komisionit në këtë rast vlerësohet se cenon edhe transparencën e procesit të rivlerësimit, i cili në themelin e tij ka nevojën e rikthimit të besimit të publikut tek institucionet e sistemit të drejtësisë.

27. Për rrjedhojë të sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se, bazuar në rrethanat e rastit në fjalë dhe në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, vendimmarrja e Komisionit për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin, znj. Eneida Civici, dhe ndalimin e ushtrimit të funksioneve të caktuara në nenin G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës për periudhën kohore prej 15 vitesh, në mungesë të njoftimit të subjektit dhe pa i dhënë asaj të drejtën për t'u dëgjuar lidhur me rezultatin e pritshëm të kësaj procedure, përbën cenim të procesit të rregullt ligjor, në kuptim të cenimit të së drejtës së subjektit për t'u dëgjuar dhe mbrojtur në mënyrë efektive, sipas përcaktimit të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6, paragrafi 1 i KEDNj-së.
28. Në vijim të sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit për cenim të procesit të rregullt nga ana e Komisionit, u gjet i drejtë dhe i bazuar. Ndodhur në këto kushte, trupi gjykues, në zbatim të kompetencave korigjuese lidhur me gabimet procedurale të kryera nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit, parashikuar shprehimisht në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, në zbatim edhe të parashikimeve të nenit 51, pika 1, shkronja "b" e ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore publike, duke i garantuar subjektit të rivlerësimit, znj. Eneida Civici, të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur në mënyrë efektive përpara një gjykate të pavarur dhe të paanshme, lidhur me të gjitha pretendimet e saj mbi procesin e rivlerësimit, të cilat do t'i kishte dhënë përpara Komisionit, në mënyrë të veçantë lidhur me efektet që passjell në ecurinë e procesit të rivlerësimit kalimtar, deklarimi i mbarimit të statusit të saj të magjistratit me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si pasojë e dorëheqjes nga detyra e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
29. Sa u takon pretendimeve të tjera të subjektit të rivlerësimit në kuadër të cenimit të parimit të procesit të rregullt ligjor, trupi gjykues arriti në përfundimin se ato lidhen me mënyrën e kryerjes nga Komisioni të procedurave për rivlerësimin kalimtar të subjektit të rivlerësimit dhe, si të tilla, nuk ndikojnë në vendimmarrjen e Komisionit objekt ankimi për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, për shkak të dorëheqjes së subjektit. Për rrjedhojë, përveç sa më sipër konkluduar në drejtëm të cenimit të së drejtës së subjektit të rivlerësimit për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, pretendimet e tjera për cenim të parimit për proces të rregullt ligjor u gjetën të pabazuara nga ana e trupit gjykues.
30. Në kuadër të shqyrtimit të shkakut të ankimit, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit, znj. Eneida Civici, pretendoi se pika 2 e vendimit të Komisionit konsiston në vendosjen e një mase ndëshkuese joproporcionale, duke qenë se dorëheqja e saj nga detyra nuk ka pasur për qëllim shmangien nga procesi i rivlerësimit, porse ka ardhur si rrjedhojë e rrethanave të shkeljeve procedurale të Komisionit dhe është në përputhje me të drejtat dhe liritë e saj për të zgjedhur një tjetër punë që nuk cenon as të drejtën e një jete të qetë familjare, trupi gjykues çmoi të mbajë në konsideratë jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit për çështje të ngjashme<sup>5</sup>. Referuar vendimmarrjeve të

<sup>5</sup> Shih arsyetimin e vendimit të Kolegjit nr. 17/2019 (JR), parag. 22.

mëparshme, Kolegji ka arritur në përfundimin se vlerësimi nëse kufizimi i parashikuar në pikën 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës është proporcional apo jo nuk mund të jetë objekt i gjykimit në Kolegji, për sa kohë që ai është një parashikim kushtetues. Kolegji është shprehur gjithashtu se në arritjen e këtij përfundimi ka mbajtur parasysh edhe qëndrimin e Gjykatës Kushtetuese në vendimin e saj nr. {\*\*\*}, datë 18.01.2017 (V-{{\*\*}})<sup>6</sup>.

31. Gjithashtu, edhe sa u takon pretendimeve lidhur me vullnetin e subjekteve të rivlerësimit për të mos iu shmangur procesit të rivlerësimit, Kolegji në vendimmarrje të tij të mëparshme<sup>7</sup> ka arsyetuar se vullneti për të mos iu shmangur procesit të rivlerësimit sipas përcaktimit të tij në dispozitat kushtetuese dhe në ligjin nr. 84/2016, shprehet vetëm nëpërmjet qëndrimit në detyrë dhe përfundimit të procesit të rivlerësimit. Sipas Kolegjit, në momentin që subjekti i rivlerësimit vendos me vullnetin e tij të lirë të ndërpresë detyrën funksionale që e bën atë subjekt të procesit të rivlerësimit *ex officio*, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, duhet të marrë parasysh edhe pasojën juridike që do të sjellë dorëheqja nga detyra në ecurinë e procesit të rivlerësimit, sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës.
32. Në kuptim të sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për dorëheqje nga detyra të diktuar nga shkeljet procedurale të Komisionit, është pretendim i cili vlerësohet pa ndikim në analizën shkak-pasojë, në kuadër të zbatimit të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, për sa kohë subjekti i rivlerësimit, referuar parashikimeve të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63 të ligjit nr. 84/2016, kishte në dispozicion instrumentin e nevojshëm procedural ligjor për të kundërshtuar para Kolegjit, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, vendimmarrjen e Komisionit, sipas saj në shkelje të të drejtave procedurale, duke kërkuar korrigjimin e tyre, pa hequr dorë nga detyra e gjyqtarit dhe humbja, për pasojë, e statusit të magjistratit. Dorëheqja e subjektit të rivlerësimit me motivin e “angazhimit në një pozicion pune jashtë sistemit gjyqësor” është shqyrtuar nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vendimi përkatës i këtij institucioni kushtetues nuk është kundërshtuar në rrugë gjyqësore nga ana e subjektit të rivlerësimit. Dorëheqja e ankueses u vlerësua nga trupi gjykues si një akt vullneti i lirë për të ndërprerë detyrën funksionale që e bënte znj. Eneida Civici subjekt të procesit të rivlerësimit *ex officio*, sipas nenit 179/b të Kushtetutës. Për rrjedhojë, ishte detyrë e subjektit të rivlerësimit të merrte parasysh pasojat juridike që do të sillte dorëheqja e saj nga detyra, referuar parashikimeve të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, jo vetëm në drejtim të ecurisë së procesit të rivlerësimit, por edhe në vijimësinë e karrierës së saj në sistemin e drejtësisë. Pasoja juridike këto të cilat gëzojnë statusin e parashikimit kushtetues dhe vlerësimi i proporcionalitetit të të cilave nuk është kompetencë e Kolegjit.
33. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, pas verifikimit të situatës faktike nëpërmjet çmuarjes së provave të administruara gjatë procesit të hetimit nga Komisioni, në analizë të legjislacionit të zbatueshëm, trupi gjykues arriti në konkluzionin se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

<sup>6</sup> Vendimi i Gjykatës Kushtetuese lidhur me kërkesën e “Jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, anëtarë të grupit parlamentar të Partisë Demokratike”, me objekt “Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i ligjit nr. 84/2016, datë 30.08.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

<sup>7</sup> Shih arsyetimin e vendimit të Kolegjit nr. 17/2019 (JR), parag. 21.4 dhe të vendimit nr. 18/2020 (JR), parag. 19.

nr. 251, datë 09.03.2020, për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Eneida Civici, dhe zbatimin e pasojës juridike të parashikuar nga pika 2 e nenit G të Aneksit të Kushtetutës, përcaktuar në pikën 2 të dispozitivit të vendimit objekt shqyrtimi, është marrë në përputhje me parashikimet kushtetuese dhe ligjore dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupit gjykues, bazuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës, në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 251, datë 09.03.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Eneida Civici.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 23.12.2020, në Tiranë.

**ANËTAR**

**Ardian HAJDARI**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

**RELATOR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

**KRYESUESE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*